



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 908 Prot.

Tiranë, më 4.10 2019

U D H Ë Z I M

Nr. 22, datë 4.10.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 2.8.2013,
TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS, “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISË SË NXËNËSVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 36 të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

I. Në Udhëzimin Nr. 25, datë 02.08.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Nënkreu IV i kreut 1 ndryshon si më poshtë:

“IV. Detyrat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka për detyrë:

- a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve t’u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;*
- b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;*
- c) të organizojë veprimtari që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimmarrëse;*
- d) të organizojë veprimtari që edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;*
- e) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës - nxënës, nxënës - mësues;*

- f) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, bulizmin, si dhe të braktisjes së shkollës;
- g) të kontribuojë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës;
- h) të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet grupmosha e tyre;
- i) të zgjedhë një herë në dy vjet nxënësit e shkollës, që do të kandidojnë për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për kategoritë e veçanta të nxënësve.”.

2. Në fund të titullit të nënkreut I të kreut 2, hiqet togfjalëshi “dhe përbërja e saj”. Gjithashtu, pas pikës 8 të këtij nënkreu, shtohet pika 9, me përmbajtje si më poshtë:

“9. Kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të përzgjidhet nga klasat 4-8 për arsimin bazë, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë nga klasat 10-11, për të fituar të drejtën të kandidojë në zgjedhjet e Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë.”.

3. Pas nënkreut I të kreut 2, shtohet nënkreu I/1, me përmbajtje si më poshtë:

“I/1. Përbërja e qeverisë së nxënësve

1. Qeveria e nxënësve ka kryetarin dhe sekretarin e saj.
2. Qeveria e nxënësve përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga nxënësit në bazë klase apo klasash paralele, sipas procedurave të parashikuara në nënkreun I të këtij kreu.
3. Kryetari i qeverisë së nxënësve:
 - a) drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve;
 - b) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve;
 - c) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve;
 - d) është përfaqësuesi i nxënësve në bordin e shkollës;
 - e) përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj;
 - f) shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës në rast të thyerjes së rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi.
4. Sekretari i qeverisë së nxënësve:
 - a) zgjidhet me shumicë votash në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve;
 - b) përgatit materialet që do të shpërndaohen në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;
 - c) mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve;
 - d) lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;
 - e) mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.
5. Anëtari i qeverisë së nxënësve:
 - a) komunikon mendimet e nxënësve që përfaqëson, në qeverinë e nxënësve;
 - b) përcjell vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson;
 - c) propozon nisma ose veprimtari, që mund të organizohen në nivel shkolle;
 - d) merr pjesë rregullisht dhe është aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

e) raporton në çdo mbledhje te kryetari i qeverisë së nxënësve.”.

4. Nënkreu III i kreut 2 ndryshohet si më poshtë:

“III. Veprimtari të qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve:

1. merr nisma për veprimtari jashtëkurrikulare jopolitike të nxënësve dhe i organizon ato në bashkëpunim me drejtorin e shkollës;
2. përgatit dhe realizon projekte, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, për plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;
3. përgatit dhe realizon projekte, pas miratimit të drejtorit të shkollës, edhe me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsim;
4. zhvillon pyetësorë mbi kënaqësinë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollë të nxënësve;
5. bashkëpunon me strukturat homologe të shkollave të tjera, brenda ose jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
6. komunikon në mënyrë të vazhduar për veprimtarinë e saj me këshillin e prindërve;
7. harton planin vjetor, mbi bazën e përparësive të identifikuara nga të gjitha klasat e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTËR

BESA SHAHINI

